



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Nr. 294/1 prot.

Tiranë, më 30.12.2025

Lënda: Dërgohet analiza vjetore e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale për vitin 2025.

Drejtuar: **MINISTRISË E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**
DREJTORISË SË POLITIKAVE PER TRASHEGIMINE KULTURORE
Rruga “ Aleksandër Moisiu”, Nr. 76, Tiranë.

1.ARRITJET KRYESORE TE QKVT GJATË VITIT 2025

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale është institucion shtetëror që zhvillon veprimtari kombëtare në fushën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. Gjatë vitit 2025, QKVT ka realizuar me sukses programin vjetor të aktiviteteve, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (KKTKJ), duke përmbushur të gjitha objektivat e parashikuara në kalendarin institucional të veprimtarisë. Zbatimi i këtij programi ka reflektuar një qasje të orientuar qartë drejt misionit themelor të institucionit për ruajtjen, dokumentimin, promovimin dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Institucioni ka zhvilluar aktivitete që kanë mbuluar disa elemente thelbësore të veprimtarisë së tij, përfshirë promovimin e trashëgimisë folklorike të dokumentuar, organizimin e festivaleve folklorike tipologjike kombëtare, mbështetjen e artizanatit si dhe përfshirjen në nisma me karakter ndërkombëtar.

Një tregues i rëndësishëm i veprimtarisë së vitit 2025 ka qenë rritja e numrit të artistëve dhe pjesëmarrësve, përmes angazhimit të grupeve të reja artistike dhe zgjerimit të përfaqësimit territorial në aktivitetet kombëtare dhe lokale. Paralelisht, QKVT ka inkurajuar përfshirjen aktive

të brezit të ri në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke e konsideruar transmetimin ndërbreznor si element kyç për vazhdimësinë e saj.

Një element tjetër thelbësor i veprimtarisë institucionale ka qenë përmirësimi i cilësisë së aktiviteteve, përmes një organizimi më të strukturuar, rritjes së nivelit profesional dhe respektimit të standardeve më të mira logjistike dhe artistike.

Organizimi i festivaleve folklorike tipologjike kombëtare ka krijuar hapësira të qëndrueshme për prezantimin e formave autentike të shprehjes folklorike, si valle popullore burimore, këngë tradicionale dhe iso-polifoni, duke forcuar lidhjen me komunitetet bartëse nga zona të ndryshme të vendit.

Në të njëjtën kohë, QKVT ka vënë theks të veçantë në dokumentimin dhe trashëgiminë e shkruar dhe të transmetuar, përmes aktiviteteve që kanë rikthyer në vëmendje figurat e studiuesve të folklorit dhe rëndësinë e ruajtjes së kujtesës kulturore. Përfshirja e institucionit në aktivitete jashtë vendit ka kontribuar gjithashtu në rritjen e dukshmërisë së QKVT dhe në promovimin e vlerave tradicionale shqiptare në një kontekst ndërkombëtar.

Veprimtaria e vitit 2025 është shoqëruar nga një pasqyrim i gjerë mediatik, përmes prezencës së vazhdueshme në media kombëtare, lokale dhe në rrjetet sociale, duke rritur dukshmërinë e aktiviteteve dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Për shkak të situatës zgjedhore në vend, u bë e nevojshme përshtatja e disa aktiviteteve në data dhe vende të ndryshme, në varësi të disponueshmërisë së bashkëpunëtorëve.

Në tërësi, veprimtaria e realizuar gjatë këtij viti dëshmon konsolidimin e rolit të Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale si institucion me rendësi në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe forcimin e rolit të saj në jetën kulturore të vendit.

Në vijim paraqiten aktivitetet e QKVT-së gjatë vitit 2025:

Nr.	Titulli i aktivitetit	Data /Muaji	Vendi
1.	Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit "Një tufë proverbash", një botim anastatik i folkloristit Sotir Kolea.	12 Shkurt	Tiranë
2.	“Panairi i Punës,”Puno dhe Jeto aty ku ke zemrën” Athinë - përfshirja e QKVT	2 Mars	Athinë

3.	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore.	23-24 Qershor	Lushnjë
4.	Panairi Kombëtar i Artizanatit, Edicioni VI.	29 Shtator	Laç
5.	Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore Artistike.	10-11 Shtator	Peshkopi
6.	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso Polifonisë, Edicioni XVI.	12-13 Dhjetor	Vlorë

Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit “Një tufë proverbash” – Sotir Kolea

Gjatë vitit 2025, QKVT organizoi një aktivitet kulturor dhe promovues me fokus në trashëgiminë folklorike të shkruar, me rastin e 80-vjetorit të botimit të veprës “Një tufë proverbash” të folkloristit Sotir Kolea. Aktiviteti vuri në qendër rëndësinë e kontributit të Koleas në studimet folkloristike dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke nxitur reflektimin mbi vlerën e proverbase shqiptare si pasuri e rëndësishme e kulturës kombëtare. Premiera e dokumentarit kushtuar jetës dhe veprës së tij kontribuoi në rikthimin në vëmendje të figurave kyçe të kulturës shqiptare dhe rolit të dokumentimit në ruajtjen e kujtesës kulturore.

Pjesëmarrja e QKVT në Panairin e Punës, “Puno dhe Jeto aty ku ke zemrën” , Athinë

Përfshirja e QKVT në Panairin e Punës të organizuar në Athinë kishte për qëllim promovimin dhe prezantimin dinjitoz të trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare përpara publikut ndërkombëtar dhe komunitetit shqiptar në Greqi.

Në kuadër të këtij aktiviteti, QKVT përzgjodhi pjesëmarrjen e tre grupeve artistike tradicionale:

1. Grupi Polifonik i Himarës

Prezantoi një program të pasur me këngë isopolifonike;

2. Ansambli folklorik “Devolli”

Prezantoi një kolazh vallesh karakteristike nga zona të ndryshme jugore;

3. Grupi i Sazeve të Kolonjës, prezantoi traditën muzikore me saze të Jugut të Shqipërisë, në funksion të promovimit dhe prezantimi të vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare. Këto grupe përfaqësuan elemente të trashëgimisë kulturore jomateriale, duke kontribuar në ruajtjen, transmetimin dhe pasurimin e vlerave tradicionale të komuniteteve përkatëse.

Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore – Lushnjë

Gjatë vitit 2025, QKVT organizoi Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore Burimore, duke krijuar një platformë të rëndësishme për prezantimin dhe ruajtjen e valleve burimore nga treva të ndryshme të vendit. Aktiviteti përfshiu grupe dhe komunitete bartëse, duke nxitur transmetimin e traditës dhe ruajtjen e autenticitetit të shprehjeve folklorike. Festivali kontribuoi në forcimin e identitetit kulturor dhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e trashëgimisë koreografike.

Panairi Kombëtar i Artizanatit, Edicioni VI – Laç

Gjatë vitit 2025, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkinë Kurbin, organizoi Edicionin VI të Panairit Kombëtar të Artizanatit, në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore. Aktiviteti mbledhi artizanë nga zona të ndryshme të vendit dhe shërbeu si një platformë e rëndësishme për promovimin e artizanatit tradicional shqiptar dhe trashëgiminë e dijeve të trashëguara brez pas brezi. Panairi kontribuoi në evidentimin e punimeve artizanale si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke nxitur ndërgjegjësimin publik, mbështetjen e artizanëve dhe forcimin e lidhjes ndërmjet traditës dhe komunitetit. Aktiviteti u shoqërua me elemente artistike folklorike, duke e kthyer në një ngjarje me ndikim kulturor dhe social për qytetin pritës dhe më gjerë.

Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike – Peshkopi

Gjatë vitit 2025, QKVT organizoi Festivalin Folklorik Kombëtar të Shoqatave Kulturore-Artistike, një aktivitet me rëndësi të veçantë në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale. Festivali mbledhi shoqata kulturore-artistike dhe grupe folklorike nga treva të ndryshme të vendit, duke krijuar një hapësirë të strukturuar për prezantimin e këngës, valleve dhe muzikës tradicionale shqiptare. Aktiviteti shërbeu si platformë për forcimin e bashkëpunimit

ndërmjet shoqatave kulturore, institucioneve vendore dhe komuniteteve bartëse, duke nxitur transmetimin e traditës dhe përfshirjen e brezave të rinj në jetën kulturore. Përmes interpretimeve artistike dhe pjesëmarrjes së gjerë të publikut, festivali kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit mbi vlerën e trashëgimisë kulturore jomateriale si pjesë thelbësore e identitetit kulturor kombëtar.

Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë – Vlorë

Gjatë vitit 2025, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale organizoi Edicionin XVI të Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, një nga aktivitetet më të rëndësishme në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Festivali mbledhi grupe polifonike nga zona të ndryshme të vendit dhe shërbeu si një platformë kombëtare për ruajtjen, promovimin dhe transmetimin e iso-polifonisë shqiptare, pasuri e njohur nga UNESCO. Në kuadër të Festivalit të Iso-Polifonisë në Vlorë, fituesit e çmimeve janë paguar nga QKVT me një vlerë simbolike, si shenjë vlerësimi dhe nderimi me rastin e 20-vjetorit të shpalljes së iso-polifonisë si pasuri e mbrojtur e trashëgimisë kulturore jomateriale nga UNESCO.

Ky edicion shënoi rikthimin e festivalit në qytetin e Vlorës pas disa vitesh mungesë, duke forcuar jetën kulturore të qytetit dhe duke rritur interesin për këtë formë të veçantë të trashëgimisë shpirtërore. Përmes interpretimeve autentike dhe përfshirjes së komuniteteve bartëse, festivali kontribuoi në ruajtjen e identitetit kulturor, në nxitjen e vazhdimësisë ndërbreznore dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale.

2.OBJEKTIVA TË REALIZUAR BAZUAR MBI TREGUES DHE TE DHENA STATISTIKORE MBI VEPRIMTARINE E KRYER KRAHASUAR NË VITIN 2024.

Krahasimi i treguesve për vitin 2025 është realizuar duke u bazuar në të dhënat dhe analizën vjetore të vitit 2024, e cila është dorëzuar dhe miratuar në përfundim të atij viti, dhe shërben si bazë referimi për vlerësimin e ecurisë së veprimtarisë institucionale.

Projekte te realizuara për Trashëgiminë Kulturore

Emërtimi i Projektit	Viti Periudha	Fusha që ka mbuluar projekti	Financuesi	Vlera e financimit
Promovim i mjeshtrove ne gernetë e violine e librit “Kaba me Gernetë “I V.Toles ne Teatri i Operas dhe Baletit	Prill/2024	TKJM(Mjeshtria ne klarinete)	Buxheti i shtetit	40.800 leke
FFTK I Kenges Qytetare ne Elbasan	Mars/2024	TKJM (kenge qytetare)	Buxheti i shtetit	823.800 leke
Panairi Kombetar i Artizanatit ne Gjirokaster	korrik/2024	TKJM(artizanat,kulinari,muzike)	Buxheti i shtetit	957.200 leke
FFTK i Lojrave Popullore dhe Riteve ne Devoll	Korrik/2024	TKJM(lojra e rite popullore)	Buxheti i shtetit	1.117.175 leke
FFTK i Sazeve ne Leskovik dhe Erseke	Shtator/Tetor 2024	TKJM (saze popullore)	Buxheti i shtetit	1.354.488 leke
FFTK i Rapsodeve dhe Instrumentisteve Popullore	Dhjetor /2024	TKJM (rapsod e Instrumentist)	Buxheti i shtetit	1.197.264 leke
Viti 2024				5.490.727 leke
Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit “Një tufë proverbash” – Sotir Kolea	Shkurt 2025	TKJM – folklor i shkruar, studime folkloristike dhe dokumentim kulturor	Buxheti I shtetit	185.000 nga viti 2024
“Panairi i Punës”, Athinë – përfshirja e QKVT	Mars 2025	TKJM (artizanat,kulinari, muzike)	Buxheti I shtetit	959.850 leke
Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore	Qershor 2025	TKJM, Valle popullore burimore dhe koreografi tradicionale	Buxheti I shtetit	1.228.500 leke

Panairi Kombëtar i Artizanatit, Edicioni VI	Shtator 2025	TKJM, Artizanat tradicional dhe dije popullore	Buxheti I shtetit	899.730 leke
Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike	Shtator 2025	TKJM, Këngë, valle dhe muzikë tradicionale shqiptare	Buxheti I shtetit	1.108.950leke
Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë, Edicioni XVI	Dhjetor 2025	TKJM, Iso-polifonia shqiptare (UNESCO)	Buxheti I shtetit	2.098.868 leke
Viti 2025				6.295.898 leke

Nr.	Aktivitetet e QKVT, viti 2024	Numër artistësh	Spektatorë
1.	Ekspozitë "Identitete të Trashëgimisë sonë shpirtërore" dhe shfaqje dokumentarësh, Berat		180
2.	“Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare”, edicioni XVIII, Elbasan	200 artistë	950
3.	Promovim libri “Kabatë me gërnetë dhe violinë” i akademikut Vasil S.Tole, Tiranë		80
4.	"Panairi Kombëtar i Artizanatit", edicioni V, "Kult – Art", Gjirokastrë	70 artizanë	850
5.	“Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Lojrave Popullore dhe Riteve”, Bilisht	140 artiste	750
6.	“Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Sazeve Popullore”, edicioni XIII, Erseke dhe Leskovik	200 artiste	720
7.	“Rikthim, Iso-Polifonia”, mbajtur në COD, Tiranë		60
8.	“ Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë”, Lezhë	170	820

Aktivitetet e QKVT – Viti 2025 (me tregues pjesëmarrjeje)

Nr.	Aktivitetet e QKVT, viti 2025	Numër artistësh	Spektatorë
1.	Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit “Një tufë proverbash” – Sotir Kolea	4 pjesëmarrës (studiues, artistë, të ftuar)	100
2.	“Panairi i Punës”, Athinë – përfshirja e QKVT	27 artistë	mijëra
3.	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore	300 artistë	850
4.	Panairi Kombëtar i Artizanatit, edicioni VI, i shoqëruar me një koncert festiv.	53 artizanë dhe 50 artiste në koncertin shoqërues	800
5.	Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike	250 artistë	750
6.	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë, Edicioni XVI	280 artistë	200

2. Objektiva të realizuar bazuar mbi tregues dhe të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e kryer, krahasuar me vitin 2024

Krahasimi i treguesve sasiore të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale për vitet 2024 dhe 2025 tregon një vijimësi të aktivitetit institucional, si dhe ndryshim të qasjes drejt aktiviteteve me karakter më tipologjik dhe të fokusuar në komunitetet bartëse të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Krahasimi i numrit të aktiviteteve

- Në vitin 2024 janë realizuar 8 aktivitete kulturore.
- Në vitin 2025 janë realizuar 6 aktivitete kulturore.

Ulja e numrit të aktiviteteve në vitin 2025 shoqërohet me një rritje të përqendrimit në festivale kombëtare tipologjike dhe aktivitete me peshë më të lartë artistike dhe organizative.

Krahasimi i pjesëmarrjes artistike

- Në vitin 2024, aktivitetet e QKVT përfshinë rreth 780 artistë/artizanë pjesëmarrës.
- Në vitin 2025, numri i artistëve dhe artizanëve pjesëmarrës arriti në rreth 911 pjesëmarrës.

Kjo tregon një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes artistike, pavarësisht numrit më të ulët të aktiviteteve, duke reflektuar një angazhim më të gjerë të komuniteteve bartëse dhe një shtrirje më të madhe të grupeve pjesëmarrëse në aktivitetet e vitit 2025.

Krahasimi i pjesëmarrjes së publikut (spektatorë)

Në vitin 2024, aktivitetet e QKVT janë ndjekur nga rreth 4410 spektatorë.

Në vitin 2025, numri i spektatorëve rezulton rreth 3450 spektatorë brenda vendit dhe pjesëmarrje shumë e lartë e publikut në “Panairin e punës në Athinë”.

Rënia relative e numrit të spektatorëve brenda vendit në vitin 2025 lidhet kryesisht me:

- Zhvendosjen e fokusit nga aktivitete masive drejt aktiviteteve me karakter më të përqendruar artistik dhe kulturor;
- Numrin më të ulët të aktiviteteve nga 8 aktivitete në vitin 2024 në 6 aktivitete në vitin 2025
- Natyrën e disa aktiviteteve të zhvilluara në ambiente të mbyllura ose me publik më të targetuar.

Analizë përmbledhëse

Në përfundim, analiza krahasuese e treguesve të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale për vitet 2024 dhe 2025 dëshmon se institucioni ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm veprimtarie institucionale, duke konsoliduar më tej rolin e tij në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Të dhënat statistikore tregojnë se, pavarësisht një numri më të kufizuar aktiviteteve në vitin 2025, është shënuar një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes artistike dhe e përfshirjes së komuniteteve bartëse, çka reflekton një përfaqësim më të gjerë territorial dhe një angazhim më të fortë të grupeve folklorike dhe artizanëve në veprimtaritë e organizuara nga QKVT.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e publikut ka ruajtur një nivel të konsiderueshëm gjatë të dy viteve, me një prirje më të përqendruar në vitin 2025, e lidhur kryesisht me orientimin e veprimtarisë drejt aktiviteteve tipologjike dhe me karakter më të specializuar. Ky zhvillim tregon një

zhvendosje të fokusit nga aktivitetet masive drejt aktiviteteve me cilësi më të lartë artistike dhe kulturore.

Në tërësi, treguesit sasiorë dhe cilësorë konfirmojnë realizimin e objektivave institucionale të QKVT-së, duke dëshmuar një qasje të qëndrueshme dhe të orientuar drejt cilësisë në ruajtjen, promovimin dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore jomateriale. Këto rezultate krijojnë një bazë të fortë për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarisë institucionale në vitet pasuese, në përputhje me misionin dhe prioritetet strategjike të institucionit.

3. PROJEKTE TË HARTUARA NGA INSTITUCIONI OSE NË BASHKËPUNIM

Gjatë vitit 2025, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale nuk ka hartuar apo zbatuar projekte të veçanta të strukturuar me financim të dedikuar, apo projekte të tjera të pavarura nga veprimtaria e saj e rregullt institucionale.

Veprimtaria e institucionit është fokusuar kryesisht në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore kombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, sipas Statutit të QKVT-së, të cilat janë pasqyruar në Pikën 1 të kësaj analize, si dhe në dokumentimin dhe promovimin e tyre. Në kuadër të kësaj veprimtarie, QKVT ka siguruar dokumentimin audio-vizual dhe pasqyrimin mediatik të aktiviteteve të zhvilluara, përmes publikimeve në rrjetet sociale zyrtare dhe në media, me qëllim rritjen e dukshmërisë së trashëgimisë kulturore jomateriale, informimin e publikut të gjerë dhe ruajtjen e kujtesës institucionale. Dokumentimi dhe promovimi i aktiviteteve kanë shërbyer si mjete mbështetëse për përhapjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në përputhje me misionin dhe funksionet e Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale. Marreveshje bashkepunimit dhe zbatimi i tyre.

Nr.	Aktivitetet e QKVT	Bashkëpunëtorët
1.	Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit <i>“Një tufë proverbash”</i> – Sotir Kolea	MEKI, Biblioteka Kombëtare Qendra “Sotir Kolea, Tiranë
2.	“Panairi i Punës”, Athinë – përfshirja e QKVT	Realizuar nga MEKI – përfshirja e QKVT në panair

3	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore	MEKI, Bashkia Lushnjë
4	Panairi Kombëtar i Artizanatit, edicioni VI, shoqeruar me nje koncert festiv.	MEKI, Bashkia Kurbin
5	Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike	MEKI, Kavajë
6	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë, Edicioni XVI	MTKS, Këshilli i Qarkut Vlorë, Bashkia Vlorë dhe Qendra Kulturore Vlorë
7	Dixhitalizim i materialeve të regjistruara të trashëgimisë kulturore këngë.	MEKI

4. INICIATIVA/PERMIRESIMI LIGJORE (PROJEK-AKTE, ETJ) TË NDËRMARRA DHE TË REALIZUARA

Gjatë vitit 2025, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale nuk ka ndërmarrë apo realizuar iniciativa ligjore të veçanta, si hartimi apo propozimi i projekt-akteve ligjore apo nënligjore. Veprimtaria e institucionit gjatë këtij viti është zhvilluar në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke u fokusuar në realizimin e funksioneve dhe detyrave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

5. RRITJA/PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

(trajnime/seminare/konferenca të organizuara ose ku kane marre pjese perfaqesues nga institucioni.)

Gjatë vitit 2025, përfaqësues të Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara në kuadër të fillimit të procesit të digjitalizimit të arkivës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe institucioneve në varësi të saj, në zbatim të urdhrat përkatës të Ministrit.

NR	TITULLI I AKTIVITETIT	PERIUDHA	PJESËMARRËSIT (Nr)	PËRSHKRIM NARATIV
1	Trajnim për administrimin dhe	22 Dhjetor 2025	3 përfaqësues	Specialistët e QKVT-së morën pjesë në trajnimin e zhvilluar në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Turizmit, Kulturës dhe

	digjitalizimin e arkivës institucionale			Sportit nr. 242, datë 26.11.2025, dhe të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale në administrimin arkivor dhe proceset e digjitalizimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
--	---	--	--	---

6. Realizimi i buxhetit per vitin 2025

a. Projekte të financuara nga buxheti i shteti dhe te zbatuara (231)

Nr	Emërtimi i objektit	Periudha	Vlera e financimit	Produkti i përfituar (përshkrim narativ)
1	Nuk kemi			Nuk kemi

b. Projekte të financuara nga buxheti i shteti (602)

Nr	Emërtimi i objektit	Periudha	Vlera e financimit	Produkti i përfituar (përshkrim narativ)
1	FFK i SHKA ne Peshkopi	nentor	60.000	Mjet me qera perdorur fondet e 602
2	Panairi i Artizanatit ne Laç	shtator	90.350	Mjet me qera dhe marketing perdorur fondet nga 602

c. Aktivitete të institucionit dhe projekte të financuara nga buxheti i shteti (p.sh me art. 604 ne rast se ka)

Nr	Titulli i Aktivitetit	Periudha-vendi	Vlera e financimit	Produkti i përfituar (përshkrim i permbledhur)
1	Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit “Një tufë proverbash” – Sotir Kolea	Shkurt 2025 Biblioteka Kombetare	185.000 nga viti 2024	Realizimi i aktivitetit
2	“Panairi i Punës”, Athinë – përshirja e QKVT	Mars 2025, Athinë	959.850 leke	Realizimi i panairit
3	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i	Qershor 2025, Lushnjë	1.228.500 leke	Realizimi i festivalit

	Valles Popullore Burimore			
4	Panairi Kombëtar i Artizanatit, Edicioni VI	Shtator 2025, Laç	899.730 leke	Realizim i panairit
5	Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike	Shtator 2025, Peshkopi	1.108.950leke	Realizim i festivalit
6	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë, Edicioni XVI	Dhjetor 2025, Vlorë	2.098.868 leke	Realizim i festivalit.

Përveç buxhetit të shtetit që është financuesi kryesor i institucionit, aktivitetet kanë pasur mbështetje financiare edhe nga bashkitë, qarqet respektive . Pa mbështetjen financiare të këtyre institucioneve nuk do ishte e mundur realizimi me sukses i tyre.

- d. Projekte të financuara nga institucione/partner ndërkombëtar dhe të zbatuara ose në proces

NR	TITULLI I PROJEKT IT	PERIUDHA	VLERA E FINANCIMIT (NË VLERË)			PRODUKTI I PËRFITUAR (PËRSHKRIM NARATIV)
			DONATO RI	B. SHTETIT bashkëfinan cim	B. SHTETIT TVSH	
1	Nuk kemi					Nuk kemi

8. PUBLIKIME NE REVISTA/BOTIME VENDASE DHE TE HUAJA

Gjatë vitit 2025, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale ka realizuar botime anastatike me rëndësi të veçantë në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke kontribuar në dokumentimin, ruajtjen dhe promovimin e folklorit të shkruar shqiptar si një komponent thelbësor i identitetit kulturor kombëtar.

Në këtë kuadër, QKVT ka realizuar botimin anastatik të veprës “Një tufë proverbash” të folkloristit Sotir Kolea, me rastin e 80-vjetorit të botimit të parë të saj. Ky botim përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e trashëgimisë gojore shqiptare, veçanërisht në fushën e proverbave, të cilat përbëjnë një pasuri të vyer të urtësisë popullore. Ribotimi anastatik është realizuar duke ruajtur formën origjinale të veprës, me qëllim garantimin e autenticitetit dhe vlerës së saj dokumentare, si dhe bërjen e saj më të aksesueshme për studiuesit, kërkuesit shkencorë, studentët dhe publikun e interesuar. Përmes këtij botimi, QKVT ka kontribuar në rikthimin në vëmendje të figurës së Sotir Koleas dhe në evidentimin e rolit të tij në zhvillimin e studimeve folkloristike shqiptare.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, QKVT ka realizuar botimin anastatik të veprës “Raccolta di Canti Popolari e Rapsodie di Poemi Albanesi”, tradotti nell’idioma italiano da Giuseppe Jubany, Albanese, (Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodish të poemave shqiptare) të autorit Zef Jubani, një vepër me rëndësi të veçantë për historinë e dokumentimit të folklorit shqiptar. Ky botim përfaqëson librin e parë të botuar nga një autor shqiptar me përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodish të poemave shqiptare dhe dëshmon për rolin pionier të Jubanit në mbledhjen, përkthimin dhe botimin e krijimtarisë popullore. Ribotimi është realizuar duke ruajtur versionin origjinal të vitit 1871, përfshirë alfabetin e përdorur nga autori, me qëllim ruajtjen e autenticitetit dhe vlerës historike të veprës. Ky botim synon të bëjë më të aksesueshme dëshmitë e hershme të folklorit shqiptar për studiuesit dhe publikun e interesuar, duke ofruar një referencë të rëndësishme për studimin e identitetit kulturor kombëtar. Përmes këtyre botimeve, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale ka kontribuar në pasurimin e literaturës shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale, në rikthimin në vëmendje të figurave kyçe të studimeve folkloristike shqiptare dhe në forcimin e misionit të saj institucional për ruajtjen, dokumentimin dhe transmetimin ndërbreznor të vlerave kulturore shqiptare.

9. PROBLEMATIKA/ SUGJERIME / PROPOZIME

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë institucionale për vitin 2025, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale ka evidentuar nevojën për forcimin e strukturës së saj organizative, rritje të kapaciteteve institucionale , në funksion të përmbushjes më efikase të misionit institucional. Rezulton e domosdoshme miratimi i strukturës të propozuar me 24 punonjes nga QKVT e dërguar

në MTKS. Domosdoshmëri më emergjente mbetet shtimi i strukture me një juristi në institucion për të garantuar mbështetje ligjore të vazhdueshme për veprimtarinë institucionale, përfshirë hartimin dhe ndjekjen e kontratave, procedurave të prokurimeve publike, procedurave administrative dhe sigurimin e përputhshmërisë ligjore të proceseve të institucionit.

Njëkohësisht domosdoshmëri është dhe shtimi në strukture të një arkivisti, i cili do të merret me administrimin e arkivit të institucionit, sistemin, ruajtjen dhe përpilimin e dokumentacionit arkivor deri në dorëzim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Domosdoshmëri është dhe siguri i bazës materiale duke na çelur fonde për investime për të bërë të mundur blerjen e fotokopjes, skanerit, kasafortë etj për dixhitalizimin e arkivës institucionale, plotësimin e kushteve të sigurisë si dhe me zbatimin e standardeve ligjore dhe profesionale në fushën e arkivistikës.

Gjatë vitit 2025 janë konstatuar kufizime buxhetore, të cilat kanë ndikuar në mundësinë për zhvillimin e një numri më të madh aktivitetesh ose për zgjerimin e dimensionit të tyre artistik dhe organizativ.

Shtimi i buxhetit kërkohet nga nevoja për të paguar artistët që marrin pjesë në aktivitetet tona me një honorar dhe një shperblim për ata që vlerësohen me çmime nga juria e festivaleve, kjo rrit konkurrencën midis grupeve dhe cilesinë artistike të tyre.

Sugjerime për përmirësim dhe zhvillim institucional

Në këtë kontekst, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale vlerëson të nevojshëm forcimin e mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve kulturore dhe zhvillimin e projekteve të strukturuar në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Si rrjedhojë shtim buxheti për të krijuar mundësi të pagesës për artistët pjesëmarrës dhe një shperblim për ata që vlerësohen me çmime nga juria e festivaleve.

Po ashtu, sugjerohet nxitja e bashkëpunimeve ndër-institucionale dhe ndërkomunitare, si dhe investimi në rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të specializuara dhe pajisjeve teknike mbështetëse.

Propozime për përfshirje dhe diversitet kulturor

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale shpreh gjithashtu dëshirën dhe angazhimin për rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve minoritare në aktivitetet kulturore kombëtare dhe

tipologjike që organizon. Ky objektiv synon të nxisë përfshirjen dhe përfaqësimin e larmisë kulturore, duke krijuar hapësira të barabarta për prezantimin e traditave, praktikave dhe shprehjeve kulturore të minoriteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore jomateriale të vendit.

10. OBJEKTIVA 2026 DHE PLAN PUNE (PERFSHIRE KARTA E PERFORMANCËS)

Plani i punës për vitin 2026 i Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale përbëhet nga programi artistik dhe kulturor i aktiviteteve tipologjike kombëtare që institucioni parashikon të zhvillojë gjatë vitit kalendarik, në funksion të realizimit të misionit të tij për ruajtjen, promovimin dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore jomateriale. Realizimi i këtij plani shoqërohet me Kartën e Performancës, e cila përcakton objektivat, treguesit dhe afatet kohore për monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë institucionale.

1. FFTK i Këngës Popullore Qytetare – muaji Mars

Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare do të mbajë edicionin XIX të tij gjatë muajit mars në qytetin e Elbasanit. Në këtë festival do të përfaqësohen qytete me traditë lëvrimin e kësaj tipologjie si qyteti i Elbasanit, Lushnjës, Korçës, Vlorës, Tiranës, Shkodrës etj.. Aktiviteti do të mbahet gjatë muajit mars si pjesë e festimeve për Ditën e Verës. Ky festival ka karakter konkurrues dhe fituesit nderohen me çmime, ndërsa pjesëmarrësit me certifikata.

2. Panairi Kombëtar i Artizanatit – muaji Maj

QKVT do të mbledhë bashkë artizanë nga të gjitha qarqet e Shqipërisë si dhe nga shqiptarët e Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe nga diaspora, në panairin kombëtar. Duke ndjekur traditën e panairove të mëparshëm, qëllim kryesor do të jetë përfshirja e atyre artizanëve të cilët mbajnë gjallë apo kanë rizgjuar, punime artizanale të rralla dhe në zhdukje. Do të nderohen me “Mirënjohje” punimet dhe artizanët më të spikatur, pjesëmarrës në këtë aktivitet. Ky aktivitet do të jetë edhe në funksion të turizmit – kulturor, ku mund të shoqërohet me koncert folklorik ose aktivitete të tjera në nxitje të turizmit.

3. FFTK i Lojërave Popullore dhe Riteve – muaji Qershor

Për të nxitur dhe motivuar të rinjtë në pjesëmarrje të aktiviteteve me karakter folklorik dhe për të mbajtur gjallë këtë traditë me vlera të jashtëzakonshme të kulturës sonë, vijojmë edicionin II të “Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Lojërave Popullore dhe Riteve”. Ky aktivitet do të sjellë në skenë ritet dhe lojërat popullore të cilat nuk praktikohen vetëm për t’u ngjitur në skenë, por janë funksionale gjatë festimeve dhe argëtimeve të ndryshme folklorike. Gjithashtu, ky aktivitet do të gjallërojë jetën artistike e kulturore, do të promovojë vlera të veçanta etnofolklorike dhe do të bëhet një prezantues i shkëlqyer i dokeve dhe zakoneve tona. Festivali do të organizohet në qytetin e Bilishtit dhe do të zgjasë dy ditë. Do të marrin pjesë grupe amatorësh të moshave të ndryshme, të cilët do të organizojnë rite dhe lojra popullore. Pjesëmarrja do të organizohet në rang Bashkie, por janë të mirëpritura edhe Shoqatat Kulturore. Ky festival ka karakter konkurues, dhe fituesit nderohen me çmime, ndërsa pjesëmarrësit me certifikata pjesëmarrjeje dhe mirënjohjeje.

4. FFTK i Sazeve Popullore – muaji Shtator

Sazet kanë një interes të madh për folklorin instrumental shqiptar për vet faktin sepse ky është zhanri që përfaqëson denjësisht polifoninë instrumentale të popullit tonë. Formacioni i Sazeve është një nga formacionet më të hershme orkestrale popullore i cili ka shoqëruar disa zona të Shqipërisë në të gjitha gëzimet dhe festat e tyre familjare e qytetare. Qytetet me traditë më të hershme për këtë lloj formacioni janë Përmeti, Kolonja, Korça, Delvina, Berati, Pogradeci e më pas kjo traditë u përhap edhe në Tepelenë, Vlorë, Devoll, Myzeqe si dhe komunitetin çam brenda vendit. Me realizimin e këtij festivali pretendojmë ta vazhdojmë traditën duke zbuluar elementë artistikë, talente dhe interpretime të reja në këtë zhanër. Interesi i madh që tregon publiku, por edhe niveli i lartë i artistëve ekzekutues, japin garanci për një veprimtari që do të ketë një impakt si në argëtimin e komunitetit dhe edukimin e tij me vlerat e kulturës sonë kombëtare, ashtu edhe në nxitjen e vetë artistëve konkurues për të ardhmen e këtij zhanri. Festivali do të zhvillohet në Ersekë dhe Leskovik, tri net, gjatë muajit shtator.

5. FFTK i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë – muaji Nëntor

Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë ka qëllim të mbledhë bashkë rapsodë të harkut e të pendës si dhe instrumentistë popullorë nga të gjitha moshat. Përmes këtij festivali krijojmë hapësira të nevojshme për shprehjen artistike në skenë dhe

vlerësimin që meritojnë krijuesit autentikë të trevave të ndryshme të vendit në përshkrimin e ngjarjeve të mëdha historike si dhe atyre me karakter legjendar e mitologjik të kombit tonë. Gjithashtu duke i dhënë këtij festivali një format ndryshe, do të përfshihen dhe instrumentat popullore të trevave shqiptare, sidomos ato të rralla dhe në rrezik zhdukjeje.

Festivali do të zgjasë dy net dhe ka karakter konkurrues. Veç çmimeve që do të japë juria, do të shpërndahen trofe mirënjohjeje dhe çertifikata pjesëmarrjeje.

6. Panairi i Transhumancës (PROPOZIM)

Qëllimi i aktivitetit është të ruajë dhe të promovojë traditën e transhumancës në të cilën Shqipëria është pjese bashkë me disa shtet të tjera si, Italia, Spanja, Andorra, Rumania etj. në listën e trashëgimisë kulturore jo-materiale të UNESCO-s. Në këtë panair synohet të prezantohen produkte ushqimore dhe veshjet tradicionale të lidhura me këtë praktike të shtegëtimit të bagëtive e cila është një traditë shekullore. Gjithashtu dhe duke theksuar rolin e transhumancën në jetën ekonomike të vendit. Të rrisë ndërgjegjësimin mbi trashëgiminë e transhumancës dhe të mbështesë prodhuesit lokal në produktet e tyre ushqimore dhe artizanale.

Panairi mund të zhvillohet në Malësi të madhe (Tamarë, Lëpushi), Tepelenë ose në rrethinat e Gjirokastrës. Ekspozitë me produktet ushqimore si: Mishi, mjalti, bulmeti, çajrat e ndryshëm të zonave malore që janë produktë tradicionale në zona ku trashumanca zhvillohet. Demonstrim i përpunimit të qumshtit dhe nënproduktet e tij. Ekspozitë ose paradë e kostumografisë të punuar në mënyrë artizanale nga bartësit e trashumancës dhe aksesorvë të tyre. Demonstrimi i zejeve si psh: qethja e dhenve, përpunimi i leshit të dhenve dhe teknika të tjera që kanë të bëjnë me punimin e veshjeve. Koncert me muzikë folklorike dhe valle tradicionale të zonave. Degustimi ushqimore i produkteve nga zonat ku praktikohet trashumanca. Ky panair të shërbejë si një platformë për promovimin e kësaj kulturë unike të trashumancës dhe një mundësi që komuniteti ta vlerësojë dhe ta ruajë këtë traditë unike.

7. Ekspozita të prezantimit të figurave të shquara “Identitete të trashëgimisë sonë jomateriale” në qytete të ndryshme të vendit. (e shtrirë në gjithë vitin)

Ekspozita sjell në vëmendje personalitete të njohura të trashëgimisë kulturore shqiptare nga të gjitha trevat shqipfolëse dhe shërben si një mënyrë e mirë për të bashkuar komunitetin dhe për

të përcjellë mesazhin se trashëgimia kulturore është një pasuri që i takon të gjithëve dhe duhet të ruhet dhe vlerësohet nga të gjithë. Këto ekspozita synojnë të theksojnë rëndësinë e personaliteteve që kanë ndikuar në ruajtjen e identitetit kombëtar përmes traditave, artit, folklorit, muzikës dhe zakoneve popullore. Ekspozitat janë një pikë referimi e rëndësishme për të kujtuar dhe për të mbrojtur pasurinë e kulturës jomateriale shqiptare, dhe për të inkurajuar të rinjtë dhe të gjithë qytetarët të mbështesin dhe të kujdesen për trashëgiminë e tyre kulturore.

8. Dixhitalizim i materialeve të regjistruara të trashëgimisë kulturore (këngë, valle, interpretime popullore) (e shtrirë në gjithë vitin)

Dixhitalizimi i materialeve të trashëgimisë kulturore ndihmon në mbrojtjen e këtyre pasurive dhe mundëson ruajtjen e tyre në formate të qëndrueshme dhe të lehta për t'u shpërndarë dhe përdorur.

Procesi do të shtrihet gjatë gjithë vitit, në mbledhje të materialeve ekzistuese.

9. Botime me përmbajtje nga foklori ynë, studime dhe përmbledhje folklori (e shtrirë në gjithë vitin).

Studime mbi elementet e ndryshme të folklorit shqiptar.

Përmbledhje të veprave të njohura folkloristike, duke përfshirë vlerësime dhe interpretim të materialeve folklorike të mbledhura nga studiues të njohur.

10. Dokumentarë për figura të shquara të trashëgimisë sonë kulturore jomateriale. (e shtrirë në gjithë vitin)

Dokumentarët përshkruajnë jetën dhe veprën e personaliteteve të shquara që kanë kontribuar në ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare.

QKVT do të vlerësojë edhe propozime të tjera në vijim të vitit kalendarik për të formësuar aktivitete të ndryshme në kuadër të trashëgimisë kulturore jomateriale, përfshirë këtu organizime të ndryshme nën programin e “Edukimit përmes kulturës” me fëmijët e shkollave.

KARTA E PERFORMANCËS – QKVT | VITI 2026

Karta e Performancës për vitin 2026 paraqet objektivat strategjike të Qendrës Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, të shoqëruara me tregues sasiorë dhe cilësorë të performancës, të cilët do të përdoren për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të planit të punës gjatë vitit kalendarik 2026.

Nr	Objektiva	Aktiviteti i Planifikuar	Tregues Performance	Afati i Parashikuar
1	Ruajtja dhe promovimi i këngës popullore qytetare	Organizimi i Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Popullore Qytetare, edicioni XIX	Planifikohet realizimi i 1 festivali Synohet pjesëmarrja e ≥ 13 grupeve. Synohet prania e ≥ 700 spektatorëve	Mars 2026
2	Mbështetja dhe promovimi i artizanatit tradicional	Organizimi i Panairit Kombëtar të Artizanatit, edicioni VII.	Planifikohet realizimi i 1 panairi Synohet pjesëmarrja e ≥ 50 artizanëve. Synohet prania e ≥ 800 vizitorëve	Maj 2026
3	Transmetimi ndërbreznor i lojërave popullore dhe riteve	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Lojërave Popullore dhe Riteve, edicioni III	Planifikohet realizimi i 1 festivali Synohet pjesëmarrja e ≥ 12 grupeve. Përfshirje e të rinjve dhe komuniteteve lokale	Qershor 2026
4	Ruajtja dhe promovimi i muzikës instrumentale tradicionale	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Sazeve Popullore	Planifikohet realizimi i 1 festivali Synohet pjesëmarrja e ≥ 15 grupeve. Synohet prania e ≥ 900 spektatorëve	Shtator 2026
5	Evidentimi dhe vlerësimi i rapsodëve dhe	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë	Planifikohet realizimi i 1 festivali Synohet pjesëmarrja e ≥ 15 interpretimeve konkurruese	Nëntor 2026

	instrumentistëve popullorë			
6	Promovimi i praktikës së transhumancës (UNESCO)	Organizimi i Panairit të Transhumancës (aktivitet pilot – propozim)	Planifikohet realizimi i 1 aktiviteti pilot. Synohet pjesëmarrja e ≥ 20 ekspozuesve Pasqyrim mediatik dhe publik	Gjatë vitit 2026
7.	Ndërgjegjësimi publik për figurat e trashëgimisë jomateriale	Ekspozita “Identitete të trashëgimisë sonë jomateriale”	Synohet realizimi i ≥ 2 ekspozitave Shtrirje në disa qytete	Gjatë vitit 2026
8	Ruajtja afatgjatë e trashëgimisë jomateriale	Digjitalizimi i materialeve audio- vizuale folklorike	Digjitalizim i materialeve ekzistuese Arkivim elektronik i qëndrueshëm	Gjatë vitit 2026
9	Pasurimi i literaturës folklorike	Botime studimore dhe përmbledhje folklori	Synohet realizimi i ≥ 2 botimeve	Gjatë vitit 2026
10	Dokumentimi i figurave të shquara të TKJM	Realizimi i dokumentarëve tematikë	Synohet realizimi i ≥ 1 dokumentari	Gjatë vitit 2026

11	Edukimi kulturor dhe përfshirja e brezit të ri	Aktivitetet “Edukimi përmes kulturës”	Synohet realizimi i aktivitetit “ Eduktimi përmes Kulturës” në bashkëpunim me shkolla	Gjatë vitit 2026
----	--	---------------------------------------	---	------------------

DREJTOR

Majlinda Cano

10	Dokumentimi i figurave të shquara të TKJM	Realizimi i dokumentarëve tematikë	Synohet realizimi i ≥ 1 dokumentari	Gjatë vitit 2026
11	Edukimi kulturor dhe përfshirja e brezit të ri	Aktivitetet “Edukimi përmes kulturës”	Synohet realizimi i aktivitetit “Edukimi përmes Kulturës” në bashkëpunim me shkolla	Gjatë vitit 2026

Konceptoi: M.Cano

A. Ilia

Miratoi: M.Cano

DREJTOR

Majlinda Cano

